Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 25 pika 4 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.01.2015, nxjerrë këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2015

Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2015, si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Janar	1Aprovimi i Strategjisë Komunale për Informim dhe komunikim, 2.Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2015, 3.Aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2015, 4.Shqyrtimi i raportit të Komitetit për Arsim.	
Shkurt	1. Orientimi I të hyrave vetanake të bartura nga viti 2014 në vitin 2015. 2.Shqyrtimi në parim I Projekt-Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenëve dhe maceve, si dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre.	
Mars	1.Shqyrtimi I raportit analitik financiar për vitin 2014. 2.Shqyrtimi dhe aprovimi I Projekt-Rregullores për kushtet e mbajtjes së qenëve dhe maceve, si dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes ose humbjes së tyre.	

Prill	1. Shqyrtimi I raportit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, 2.Shqyrtimi I raportit finnaciar për periudhën Janar- 31 Mars 2015.	
Maj	2. Plotësimi dhe ndryshimi I Rregullores mbi taksa, tarifa dhe gjoba komunale.	
Qershor	1. Shqyrtimi I draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2016-2018, 2. Shqyrtimi dhe aprovimi I Rishikimit të buxhetit për vitin 2015, 3. Mbledhja e I-rë Publike për vitin 2015.	Diskutim publik me qytetar Për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016-2018.
Korrik	1.Raporti gjashtëmujor I Kryetarit, 2.Raporti analitik gjashtëmujor financiar, 3.Marrja e Vendimit për pushim vjetor të anëtarëve të Kuvendit.	
Gusht	Pushim	
Shtator	1. Shqyrtimi dhe miratimi I Buxhetit për vitin 2016. 2. Shqyrtimi dhe miratimi I Rregullores mbi Tatimin në pronë. 3.Njoftim nga Ekzekutivi mbi përgaditjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2015/2016.	
Tetor	1.Shqyrtimi I Raportit nëntë mujor financiar, 2.Shqyrtimi I Raportit të Komitetit për Shëndetësi, 3.Inicimi I procedurës për rishikimin e Strategjisë	

	Zhvillimore të Komunës së Deçanit.	
Nëntor	1. Shqyrtimi I raportit të Auditorit të Jashtëm.	
Dhjetor	1. Shqyrtimi I Raportit vjetorë të Kryetarit të Komunës. 2. Mbledhja e II-të Publike për vitin 2015.	

Neni 2.

Kuvendi i Komunës përveq pikave të paraqitura nga neni 1. i këtij vendimi gjatë vitit 2015 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

01.Nr.I-4
Deçan,dt.30.01.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • DEÇANI MUNICIPALITY • Komunal Assembly • Skupština Opštine • OPŠTINA DEČANE • REPUBLIKA E KOSOVËS • DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj

HYRËSE-LLAZHA-INGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPŠTINA DEČANE - DEÇANI MUNICIPALITY
Nga: Kk- Deçan
Nr. Prot: 2412
Data: 23-02-15
Nr. i faqeve: 01